



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2461/2 prot.,

Datë 09.10.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ANBIM” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-79330-09-08-2023, me objekt: “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 2.080.000. Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 22.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.

Ankimues: Operatori ekonomik “ANBIM” SHPK me Nipt. L81618008J
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kukës.
Adresa: Sheshi: Skenderbej, Lagjja Nr.5, Kukës.

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “ANBIM” SHPK me numër ankimi elektronik A/2023/3477, datë 08.10.2023, dhe me nr. 2461/2023 prot., datë 09.10.2023 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-79330-09-08-2023, me objekt: “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 2.080.000. Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 22.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “ANBIM” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar”.

Komisioni i Prokurimit Publik, do të publikojë arsyen e skualifikimit, të cilën operatori ekonomik ankimues “ANBIM” SHPK, kundërshton në ankesën e ardhur, si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“OE nuk permbush piken 2.2/b (tek kriteret e vecanta te kualifikimit) te percaktuar ne DST, pasi bilanci financiar i vitit 2022 eshte i pakonfirmuar nga administrata tatimore.”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 09.10.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Nënkryetar

Fiorent Zguro